

Data 31.07.2026

**PROCESVERBAL – TIPI KONTRATËS – SHËRBIME
(PROCEDURË E HAPUR, MBI KUFIRIN E LARTË MONETAR)
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “SIGURIMI I ASETEVE TË KESH SH.A”.

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): SHËRBIME
SIGURIMI 983441140-8.**

VLERA E FONDIT LIMIT: 170,756,219 (Njëqind e shtatëdhjetë milion e shtatëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e nëntëmbëdhjetë) Lekë ose 1,824,903 (Një milion e tetëqind e njëzetë e katër mijë e nëntëqind e tre) Euro.

Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datë 31.07.2026 është 93.57 Lekë/Euro.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar autoriteti/enti kontraktor Korporata Elektroenergjitike Shqiptare, KESH sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;

Argumentimi:

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimet” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës” të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar. Në Nenin 83 të Ligjit Nr.162/2020 “Për

Prokurimin Publik” i ndryshuar citohet: *“Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP i ndryshuar “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet Kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, i ndryshuar nenit 41, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së përllogaritur të fondit limit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, i ndryshuar si dhe nenin 43 pika a e VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë specifikën e mallrave objekt procedure prokurimi, kërkohet që Operatori Ekonomik ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë operatori ekonomik ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për tre vitet e fundit financiare të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së përllogaritur të fondit limit. Kjo vlerë është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumen e saj, vlerën e fondit limit, me qëllim që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet

të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Vlera e xhiros për tre vitet e fundit financiare të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së përlogaritur të fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se:

“Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: a) dyfishin e vlerës së përlogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar.

Vlera e xhiros së përcaktuar dhe të kërkuar nga autoriteti kontraktor kërkohet për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike të operatorit ekonomik si dhe për të vendosur kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në dispozitat e legjislacionit:

Ligjin Nr. 29/2023 Për tatimin mbi të ardhurat (Ndryshuar me aktin normativ nr. 2, datë 7.6.2023; aktin normativ nr. 7, datë 14.12.2023; vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 52, datë 27.6.2024; aktin normativ nr. 4, datë 27.11.2024, ligjin nr. 9/2025, datë 30.1.2025; nr. 81/2025, datë 11.12.2025) (i përditësuar).

Vendim nr. 211, datë 9.4.2025 Për disa ndryshime në vendimin nr. 922, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave. “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”. Udhëzim nr. 24, datë 6.11.2025 për disa shtesa dhe një ndryshim në udhëzimin e përgjithshëm nr. 26, datë 8.9.2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbime të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 39 % e fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi:

Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në një vlerë jo më të vogël se 39 % e fondit limit, brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Kjo përqindje është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 41 pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ku citohet se:

Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e shërbimeve të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

Kjo kërkesë ka si qëllim sigurimin e faktit që operatori ekonomik ka përvojë dhe aftësi të mjaftueshme për të realizuar kontrata të ngjashme me atë që po kërkohet. Në këtë mënyrë, Autoriteti Kontraktor synon të sigurojë se operatori ekonomik ka kapacitetin për të përmbushur kërkesat dhe për të ofruar shërbime që janë të ngjashme në natyrë dhe në vlerë me ato që janë të parashikuara në kontratë.

2.3.2 Ofertuesi duhet të jetë kompani sigurimesh, e cila të përmbushë të gjitha kërkesat e Legjislacionit të fushës, e pajisur me leje për ushtrim të aktivitetit sigurime dhe/ose risigurime nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare, ku të jenë specifikuar qartë grupet/klasat për sigurimet e kërkuara në këtë tender. Përfshihen nga kjo procedurë Brokerat dhe agjentët e sigurimeve.

Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti operatori ekonomik duhet të paraqesë Licencën “Për të ushtruar veprimtari sigurimi jo-jete, në territorin e Republikës së Shqipërisë” ku përfshihen Klasat 8 dhe 9, respektivisht – sigurimi nga zjarri dhe forcat e natyrës dhe sigurimi i dëmtimeve të tjera të pasurisë, të lëshuara nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare (AMF).

Argumentimi:

Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/a, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku pika 4/a citon se :

“Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: **licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore**”.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

Konkretisht :

Kjo kërkesë është në përputhje me objektin e kontratës dhe në përputhje me termat e referencës pasi qëllimi i objektit të prokurimit është kryerja e sigurimit të aseteve për një periudhë një vjeçare, nga ngjarje si: zjarri, tërmeti, rënie e objekteve fluturuese dhe përmbytje, përmbledhur si rrezeqe të tjera. Rikuperimi në raste ngjarjeje sigurimi, të vlerës së siguruar të aseteve (shuma e siguruar).

Asetet gjeneruese të KESH sh.a., si dhe tërësia e aseteve të tjera që lidhen me këto asete gjeneruese, përbëjnë kapacitetin më të madh gjenerues në vend të energjisë elektrike dhe si rrjedhojë kanë rëndësi të veçantë jo vetëm për shoqërinë, por edhe me gjerë, me efekte në të gjithë sektorët ekonomik në vend. Për këtë arsye, këto asete janë nën një regjim të posaçëm ligjor. Përpos faktit që janë nën pronësinë e shtetit Shqiptar, mbi këto asete KESH sh.a. gëzon përgjegjësi administrimi, referuar akteve nënligjore në fuqi.

Bazuar në rëndësinë, natyrën e objektit të prokurimit si dhe vlerës së fondit limit, Autoriteti Kontraktor për të realizuar me sukses këtë kontratë kërkon kompani sigurimesh serioze (jo Brokera dhe Agjentët e sigurimeve) të cilat të përmbushin të gjitha kërkesat e Legjislacionit të fushës, të pajisur me leje për ushtrim të aktivitetit sigurime dhe/ose risigurime nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare, ku të jenë specifikuar qartë grupet/klasat për sigurimet e kërkuara në këtë tender.

Ky kriter garanton autoritetin kontraktor që operatori ekonomik është i autorizuar ligjërisht të ofrojë mbulimin e kërkuar sipas legjislacionit në fuqi “Për veprimtarinë e sigurimit dhe të risigurimit”.

2.3.3 Ofertuesi duhet të ketë kontratë Risigurimi në zbatim të Ligjit 52/2014, datë 22.05.2014 “Për Veprimtarinë e Sigurimit dhe Risigurimit”, Neni 115, 116 dhe 117 si dhe kriteret për përcaktimin e nivelit të risiguruesit, sipas “Rregullores për Kriteret e Risigurimit”, të miratuar me Vendimin e Bordit të AMF-së Nr.85/1 datë 30.09.2015, ndryshuar me Vendim Bordi të AMF-së Nr.88, datë 27.06.2016.

Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti operatori ekonomik duhet të paraqesë Kontratë risigurimi të vlefshme në momentin e shpalljes së tenderit me Risigurues të kredituar sipas përcaktimeve të “Rregullores për Kriteret e Risigurimit“, të miratuar me Vendimin e Bordit të AMF-së Nr. 85/1 datë 30.09.2015, ndryshuar me Vendim Bordi të AMF-së Nr.88, datë 27.06.2016, të klasifikuar nga Standard & Poors, Fitch, Moody’s dhe AM Best.

Argumentimi:

Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” pika 4, i ndryshuar në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

Konkretisht:

Kjo kërkesë është në përputhje me Ligjin 52/2014, datë 22.05.2014 “Për Veprimtarinë e Sigurimit dhe Risigurimit”, i cili rregullon krijimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e shoqërive të sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit, me qëllim që tregu i sigurimeve të veprojë në një mjedis të sigurt, të qëndrueshëm dhe transparent në mbrojtje të të drejtave dhe interesave të konsumatorit.

Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njehsimin e dokumenteve.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, sipas parashikimeve të nenit 36 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike janë hartuar nga Grupi i punës (sipas procesverbalit pjesë integrale e kësaj procedure) ku në të citohet se:

KESH sh.a, është një shoqëri tregtare, me kapital të zotëruar 100% nga Shteti Shqiptar, e cila ushtron veprimtari në prodhimin dhe tregtimin e energjisë elektrike në Shqipëri. Shoqëria shfrytëzon për qëllime të ushtrimit të aktivitetit njësi prodhimi energjie HEC-e të ndodhura përgjatë lumit Drin në formë kaskade, si dhe asete të tjera të luajtshme dhe të paluajtshme, ndihmëse për aktivitetin kryesor.

Asetet gjeneruese të KESH sh.a, si dhe tërësia e aseteve të tjera që lidhen me këto asete gjeneruese, përbëjnë kapacitetin më të madh gjenerues të energjisë elektrike dhe si rrjedhojë, kanë rëndësi të veçantë jo vetëm për shoqërinë, por edhe më gjerë, me efekte në të gjithë sektorëteknomik në vend. Për këtë arsye, këto asete janë nën një regjim të posaçëm ligjor. Pëson faktit që janë në pronësi të Shtetit Shqiptar, mbi këto asete, KESH sh.a. gëzon përgjegjësi administrimi, referuar akteve nënligjore në fuqi.

Rreth 60% e energjisë në vend prodhohet nga këto asete gjeneruese dhe qarkullohet nga shoqëria KESH sh.a. nëpërmjet marrëdhënieve tregtare.

Çdo subjekt i cili mban të drejta dhe detyrime mbi asete të caktuara, ballafaqohet me mundësitë e dëmtimit të tyre nga ngjarje të ndryshme, për menaxhimin e të cilave mbajtësit e të drejtave përdorin mekanizma të ndryshëm, duke filluar nga administrimi i asetit/eve, menaxhimi i qarkullimit të tij, ruajtja e tij fizike e deri në përdorimin e mekanizmave të sigurimit të aseteve me palë të treta.

Rregullimet ligjore të aplikueshme nga ana e shoqërisë KESH sh.a, për menaxhimin e aseteve në përdorim, si dhe në tërësi të menaxhimit financiar, janë ato të parashikuara në Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në bazë e për zbatim, Urdhrit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

Në bazë të këtyre parashikimeve dhe proceseve që synojnë krijimin e sigurive në menaxhimin e ngjarjeve që mund të sjellin efekte negative mbi asetet, shoqëria KESH sh.a, në vazhdimësi ka realizuar sigurimin e aseteve të shoqërisë për grupet e aseteve me rëndësi të veçantë, si : ndërtesa, makineri, pajisje dhe pajisje elektronike, për ngjarje të tilla si: si zjarri, tërmeti, rënia e objekteve fluturuese dhe përmblytje, përmbledhur si rreziqe të tjera.

Bazuar në sa më sipër dhe në politikat e shoqërisë për menaxhimin e ngjarjeve që mund të sjellin dëmtime mbi asetet, shoqëria kërkon të realizojë një shërbim nëpërmjet të cilit mundësojë për KESH mbulimin e risqeve që mund të vinë në asetet e shoqërisë nga ngjarje që mund të sjellin dëmtimin e tyre.

Njësia e Prokurimit